



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.29

Prishtinë, më 14.10.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N 302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popović, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi.

.

Pjesëmarrës të tjerë: Azem Guri dhe Hysen Bytyqi – MASHT, Rexhep Ismajli, Jusuf Krasniqi, Mehmet Kraja, Lindita Pula - ASHAK, dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektlgjit për Provimin e Maturës Shtetërore;
3. Shqyrtimi i Projektlgjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore.

Nait Hasani, i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me takimin me përfaqësuesit e GIZ në të cilin takim janë paraqitur disa komente në nenet e caktuara të Projektligjit.

Komisioni diskutoi lidhur me komentet e paraqitura nga GIZ dhe vlerësoi se këto propozime e avansojnë bazën ligjore për organizimin e provimit të maturës shtetërore.

Amendamenti 2

Neni 2, riformulohet si vijon:

1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këtë kuptim:

1.2. **Kandidat** - është nxënësi, personi i cili e përfundon me sukses klasën përfundimtare të arsimit të mesëm të lartë dhe i nënshtrohet provimit të maturës shtetërore.

Amendamenti 6

Neni 7, riformulohet si vijon:

Neni 7

Organet kompetente

1. MASHT është autoriteti shtetëror përgjegjës për organizimin e provimit të maturës shtetërore në bashkëpunim me:

1.1. Komisionin Shtetëror të Maturës (KSHM).

1.2. Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA).

1.3. Shkollat e mesme të Larta.

1.4. Komisionet e qendrave të testimit.

2. Pasi të themelohet Agjencia e Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim përgjegjësia për organizimin e provimit të maturës shtetërore bartet nga DVSM-se tek Agjencia.(bartet tek dispozitat kalimtare)

Amendamenti 7

Neni 8, riformulohet si vijon:

Neni 8

Komisioni Shtetëror i Maturës

1. Komisioni Shtetëror i Maturës (KSHM), është organ vendimmarrës, mbikëqyrës, organizativ, vlerësues, analizues dhe këshillues për maturën.

2. Komisioni Shtetëror i Maturës ka dymbëdhjetë (12) anëtarë me mandat tre vjeçar (3) në këtë përbërje:

2.1. MASHT tre (3) anëtarë, njeri nga ta kryetar.

2.2. DVSM një (1) pa te drejte vote.

2.2. Institucionet e arsimit të lartë tre (3) anëtarë,

2.3. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës një (1) anëtar,

2.4. DKA një (1) anëtar,

2.5. Përfaqësues nga drejtorët e shkollave të mesme të larta nga gjimnazet dhe shkollat profesionale dy (2) anëtar,

2.6. Përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve të Kosovës një (1) anëtarë.

3. Ministri emëron Komisionin Shtetëror të Maturës, duke pasur parasysh barazinë gjinore dhe etnike.

Amendamenti 29

Neni 29 riformulohet si vijon :

Neni 29 Sanksionet

1. Kryetari, anëtari, administruesi, mbikëqyrësi dhe vëzhguesi i testit të maturës i cili nuk i përfillë rregullat e administrimit të testit, konsiderohet si shkelje e lehtë, dhe dënohet për kundërvajtje në shumë prej treqind euro (300) € deri në pesëqind euro (500) €.
2. Kryetari, anëtari, administruesi, mbikëqyrësi dhe vëzhguesi i testit të maturës, i cili zbulon ndonjë sekret të testit që konsiderohet si shkelje e rëndë e testit të maturës dënohet me dënim në të holla prej një mijë (1000) deri në tremijë (3000) € si dhe me masa disiplinore dhe penale të parapara në Kodin Penal të Kosovës si vepër penale e zbulimit të paautorizuar të informacionit të besueshëm.
3. Kandidatët të cilët gjatë provimit të maturës shkelin rregullat e administrimit , të përcaktuara me udhëzues përkatës për provim të maturës shtetërore, sanksionet i cakton KShM-ja.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;

Anëtarët e Komisionit vazhduan me shqyrtimin nën për nen të Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe propozuan këto amendamente:

Amendamenti 18

Neni 17 riformulohet si vijon:

1. Kryetari i Akademisë e :

- 1.1. Udhëheq punën e Akademisë;
- 1.2. Përfaqëson dhe e prezanton Akademinë;
- 1.3. Udhëheq punën e Kryesisë dhe të Kuvendit të Akademisë;
- 1.4. Zgjidhet nga Kuvendi i Akademisë për një periudhë katërvjeçare me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër;
- 1.5. Nënshkruan të gjitha vendimet e Kryesisë dhe të Kuvendit;
- 1.6. Përgjigjet për ligjshmërinë e punës të Akademisë;
- 1.7. Për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë, ndërsa në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Kryesisë së Akademisë, i përgjigjet Kryesisë.

Amendamenti 19

Neni 19 titulli dhe paragrafi 1 riformulohet si vijon:

Neni 19 Anëtarë i rregullt

1. Anëtarë i rregullt i Akademisë mund të zgjidhet punonjësi i shkencës ose i artit për të arritura të veçanta në fushat e shkencës dhe të artit.
2. Titullin Akademik mund ta bartë vetëm anëtari i rregullt i Akademisë.
3. Anëtarë i rregullt i Akademisë mund të zgjidhet shtetasi i Kosovës që është punonjës i shquar i shkencës dhe të artit që ka arritje shkencore dhe artistike, veprat e të cilit paraqesin realizime kulmore në fushat e shkencës ose të artit dhe janë me peshë në vend dhe jashtë tij.

Amendamenti 20

Neni 21 riformulohet si vijon:

1. Anëtarë i jashtëm i Akademisë mund të zgjidhet punonjësi i shkencës ose i artit që jeton dhe vepron jashtë vendit, i cili ka krijuar vepra të rëndësishme për Kosovën, ose me vlerë të përgjithshme për shkencën dhe artin.
2. Anëtarit të jashtëm të Akademisë i pranohet statusi i anëtarit të rregullt ose korrespondent në pajtim me Statutin e Akademisë.

Amendamenti 21

Neni 22 riformulohet si vijon:

Anëtarë nderi i Akademisë mund të zgjidhet krijuesi i shquar i shkencës dhe i artit, që nuk është shtetas i Kosovës, i cili me veprën e tij është bërë përgjithësisht i njohur për shkencën ose artin, dhe i cili ka dhënë kontribut për Kosovën.

Amendamenti 22

Neni 23 dhe 24 bashkohen ne një nen të vetem si vijon:

1. Zgjedhjet për anëtarë të Akademisë bëhen për çdo katër vjet.
2. Procedura e propozimit, e votimit dhe e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë përcaktohet me Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë.
3. Anëtarë të Akademisë mund të zgjidhen kandidatët që nuk e kanë kaluar moshën mbi 65 vjeç.

Amendamenti 23

Neni 25 riformulohet si vijon:

Anëtari i rregullt dhe korrespondent i Akademisë merr detyra e përgjegjësi dhe gëzon të drejta të përcaktuara me këtë Ligj dhe me Statutin e Akademisë.

Amendamenti 24

Neni 26 riformulohet si vjon:

1. Anëtarit të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë me qëndrim të përhershëm në vend, ju takon shpërblimi i përhershëm mujor.
2. Lartësia e shpërblimit për anëtarin e rregullt dhe korrespondentë të Akademisë bazohet në vendimin nr. 02/211 të 16 gushtit 2006 të Qeverisë së Kosovës dhe do të ndryshojë në varësi prej vendimeve për lartësinë e pagave të profesorëve të rregullt dhe të asociuar universitar.
3. Anëtarëve të kryesisë, Kryetarit, Nënkyetarit, Sekretarit shkencor dhe sekretarëve të seksioneve, u takon shtesa mujore për funksionet që i kryejnë.
4. Kriteret dhe lartësia e shtesave mujore të anëtarëve të Akademisë për funksionet që i kryejnë në Akademi, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Amandamenti 25

Neni 27 riformulohet so vijon:

1. Shërbimet profesionale administrative e teknike i kryen administrata e Akademisë.
2. Sekretari i Akademisë është udhëheqës i administratës së Akademisë.
3. Sekretari i Akademisë zgjidhet nga Kryesia e Akademisë me konkurs publik.
4. Sekretari i Akademisë për punën e vet i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë së Akademisë.

5. Të punësuarit në shërbimet profesionale, administrative, e teknike kanë statusin e nëpunësit civil, që rregullohet me legjislacionin për shërbimin civil dhe Statutin e Akademisë.

Amendamenti 26

Titulli i Kapitullit VI si dhe neni 28 riformulohen si vijon:

KAPITULLI VI – FINANCIMI DHE MJETET E AKADEMISË

Neni 28 Burimet financiare

1. Burimet financiare për punën e Akademisë sigurohen nga Buxheti i Kosovës.
2. Me mjetet nga buxheti i Kosovës mbështetet puna e seksioneve, instituteve hulumtuese, qendrave të tjera studimore të Akademisë, puna e organeve të qeverisjes së Akademisë, bashkëpunimi ndërkombëtar i Akademisë, veprimtaria e rregullt botuese dhe periodike e Akademisë, pasurimi i fondit të bibliotekës së Akademisë, shpërblimet e përhershme mujore të anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë, shtesat për kryerjen e funksioneve të caktuara në Akademi, pagat e përhershme mujore për të punësuarit në shërbimet profesionale, administrative, e teknike dhe të mirëmbajtjes së Akademisë.
3. Akademia mund të sigurojë mjete edhe nga donacionet dhe sponsorizimet dhe ato mjete mund t'i përdorë për veprimtarinë plotësuese të saj.
4. Akademia mund të sigurojë mjete të tjera plotësuese për punën kërkimore-shkencore e artistike të anëtarëve të saj të rregullt dhe korrespondentë përmes aktiviteteve të veta, marrëveshjeve të ndërsjella kërkimore-shkencore e artistike dhe përmes donacioneve e dhuratave sipas legjislacionit në fuqi.

Amendamenti 27

Neni 29 paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Akademia është pronare e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme që ka për kryerjen e veprimtarisë së saj.
2. Akademia është titullar i vetëm juridik që mund të marrë vendim për bartjen e të drejtave të saj pronësore.

Amendamenti 28

Neni 30 riformulohet si vijon:

Neni 30 Aktet normative

Brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Akademia harmonizon organizimin, Statutin dhe aktet e tjera normative, me dispozitat e këtij ligji.

1. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani